

Kronikë nga seanca 40-të

Shkup, 22.10.2019. – Në seancën e sotme, për shkelje të nenit 62 paragrafi 6 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe nenit 22 nga Rregullorja për teknikat minimale, ambiente, finansat dhe kushtet kadrovike për dhënien e licencës për transmetim në radio dhe transmetim televiziv, këshilli i Agjencisë inicoi procedurën për marrjen e licencës për transmetim televiziv ndaj TRD 1 TV SHPKPV Shkup.

Bazuar në konstatimet nga mbikëqyrja e rregullt e Kompanisë së telekomunikacionit dhe operatorit kabllovik softuerik KABLEKALL import-eksport SHPKPV Kërçov nuk ka vepruar sipas Vendimit për paralajmërim të hershëm dhe përjashtim të ritransmetimit të paketave programore, pra nuk e harmonizon punën e saj me nenin 141 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, për këtë shkak Këshilli i Agjencisë filloi një procedurë kundërvajtëse.